



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 68

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Prishtinë, më 16 prill 2013, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Nazane Breca, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa dhe Flora Brovina.

Munguan: Sasha Gjokiq, Liburn Aliu dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj– koordinatorë e Komisionit, Xheneta Sopjani-praktikante dhe Ervin Ibrahim - UNDP.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 21.3.2013 dhe 26.3.2013;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për sigurin dhe shëndetin në punë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 21.3.2013 dhe 26.3.2013

Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më, 21.3.2013 dhe 26.3.2013

3. Shqyrtimi i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë

Fikrim Damka – I njoftoi anëtarët e Komisionit, se raportet nga komisionet e përhershme për Projektligjin për siguri dhe shëndet në punë kanë ardhur, dhe vetëm Komisioni për Legjislacion ka një rekomandim, që në preambulë të projektligjit të fshihet thirrja në nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

A pajtoheni që rekomandimi i Komisionit për Legjislacion të shkoj si amendament i ri?

Komisioni njëzëri pranoi rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, që në Projektligj të shtohet një amendament i ri dhe në preambulë të fshihet thirrja në nenin 49.

Komisioni njëzëri miratoi raportin përfundimtar me amendamente për Projektligjin për siguri dhe shëndet në punë, dhe e procedoi për miratim në seancën plenare.

4. Të ndryshme

Fikrim Damka – Tha se në këtë pikë kemi formimin e grupeve punuese për tri Projektligjet që kanë kaluar leximin e parë në seancë.

Për Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave, formohet grupi punues në përbërje: Salihe Mustafa – kryesuese, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Gëzim Kelmendi dhe Flora Brovina, anëtarë.

Për Projektligjin për produkte medicinale dhe pajisje medicinale, formohet grupi punues në përbërje: Fikrim Damka – kryesues, Flora Brovina, Time Kadrijaj, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Gëzim Kelmendi dhe Liburn Aliu, anëtarë.

Për Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, kryetari propozoi që grupi punues të kryesohet nga deputeti Liburn Aliu, pasi Projektligji është i propozuar nga Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes. Mirëpo, pasi që deputeti Liburn Aliu, nuk është prezent duhet ta pyesim atë.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka